

**Dy kroçera turistikë brenda pak ditësh në portin më të madh të vendit.**

**09.09.2011**



Dy kroçera me turistë nga vende të ndryshme të botës kanë rifilluar lundrimet drejt Durrësit në muajin shtator.

Anija turistike “Arion” ka qëndruar gjatë gjithë ditës së enjte në portin detar, ndërsa të hënën, më 12 shtator, pritët të ankorohet kroçera “Kristina Katarina”.

Nga të dhënat e agjencive të dy kroçerat së bashku sjellin rreth 750 turistë në qytetin bregdetar. Vizitorët e huaj, të grupuar me autobuzët e agjencive pritëse zakonisht i drejtohen qyteteve të Krujës dhe Tiranës, ndërsa një pjesë tjetër preferojnë të njihen nga afër me monumentet dhe muzeun arkeologjik të Durrësit.

Që prej 3-4 vitesh Durrësi është një destinacion i preferuar turistik dhe numri i kroçerave që vizitojnë portin detar në kuadër të tureve Mesdhetare disaditore ka ardhur në rritje. Sipas operatorëve turistikë kompania gjermane “Studius” dhe ajo nordike “Tui Skandinav” e kanë vënë vendin tonë në krye të listës së qendrave më të vizitueshme evropiane. Veç turistëve nga Britania e Madhe, Franca, Belgjika, Gjermania, etj. gjatë kësaj vere nuk kanë munguar edhe vizitorë nga SHBA, Turqia, Rusia, etj.

Autoriteti Portual i Durrësit është kujdesur që kroçerat të ankorohen në kalatat 4 dhe 5 të portit, shumë pranë qytetit.

Gjatë këtij sezoni veror në portin më të madh të vendit janë ankoruar kroçerat “Arion”, “Kristina Katerina”, “Island Sky” dhe “Ocean majesty”, të cilat deri tani kanë kryer 17 lundrime gjithsej drejt Durrësit me rreth 4500 turistë nga vende të ndryshme të botës në bord-thanë burimet portuale. Në kalatat e portit janë ankoruar gjithashtu dhjetra jahte dhe barka me vela, të cilat kryejnë lundrime në porte të ndryshme të Adriatikut dhe Jonit.

